

Përkrahur nga:



**Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology**

Datë: 06.09.2017

Prishtinë

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, në bashkëpunim me donatorët Roma Education Fund (REF), Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS përmes projektit të Bashkimit Evropian - EU SIMRAES 2 dhe Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE) përkrahur nga HEKS shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian për vitin shkollor 2017/2018

1. Kushtet e përgjithshme për ndarjen e bursave:

Bursat ndahen për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të regjistruar në klasën e 10-të, 11-të, 12-të, të arsimit të mesëm të lartë, gjimnaze dhe shkolla profesionale në Kosovë, për vitin shkollor 2017/2018.

2. Qëllimi i projektit të bursave:

Qëllimi i projektit për ndarjen e bursave është ofrimi i mbështetjes financiare për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së bashku me donatorët dhe partnerët implementues mbështet politika dhe programe të cilat sigurojnë arsimim kualitativ edhe për nxënësit e komuniteteve.

Objektivat kryesore të projektit janë:

- a. Përfshirja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë;
- b. Sigurimi i iniciativave, përfshirë ndarjen e bursave për të reduktuar braktisjen e mësimit tek nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
- c. Rritja e numrit të nxënësve të cilët do të ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përmes mbështetjes financiare me bursa;
- d. Ngritja e suksesit të nxënësve duke iu ofruar mbështetje financiare.

3. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a. Vërtetimi nga shkolla se nxënësi është në njërin nga klasat e shkollës së mesme të lartë për vitin shkollor 2017/2018;
- b. Dëftesa origjinale për shikim dhe kopja e të njëjtës për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) - arsimit të obligueshëm, ose dëftesa mbi përfundimin e vitit paraprak të shkollës së mesme të lartë;
- c. Aplikacioni i plotësuar, të cilin mund ta shkarkoni në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) <http://masht.rks-gov.net/publikimet>;
- d. Për raste sociale - Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale i cili vërteton se familja merr ndihmë sociale dhe Vërtetimi nga Qendra për Punësim për statusin e punësimit për të dy prindërit (1, apo kujdestarin) që të dy prindërit janë të papunë;
- e. Në rast se prindi është në marrëdhënie pune preferohet të silllet kontrata e punës;
- f. Për fëmijët jetimë - të dorëzohet vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- g. Ekstrakti i lindjes dhe në rast të posedimit të letërnjoftimit apo pasaportës të silllet kopja e dokumentit;
- h. Vetëdeklarimi për përkatësinë etnike nga aplikuesi;
- i. Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës (personale dhe/apo e prindit);
- j. Të gjithë që posedojnë llogari bankare të sjellin kopjen e llogarisë personale apo të prindit.

4. Kushtet për ndarjen e bursave:

Përzgjedhja e fituesve të bursave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në vijim:

- a) Suksesi i bazuar në notë mesatare nga shkolla/klasa paraprake;
- b) Vërtetimi për gjendjen socio - ekonomike të nxënësit (punësimin e prindit, statusin familjar dhe jetesën) - vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale;
- c) Vendbanimi (distanca shkollë - shtëpi);
- d) Gjinia e nxënësit (kandidatët femra kanë përparësi në përzgjedhje);
- e) Mungesa e përkujdesit prindëror (sipas dëshmisë).

Kandidatët rangohen sipas numrit të tërësishëm të pikëve të fituara nga kriteret e përcaktuara me këtë konkurs.

5. Afati i aplikimit dhe përzgjedhja e përfituesve:

Afati për aplikim fillon më 06.09.2017 dhe mbaron më 15.09.2017

Aplikimi pas përfundimit të afatit të lartshënuar si dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

E drejta e ankesës do të mund të bëhet brenda dy ditëve, nga dita e shpalljes së listës së përfituesve. Rezultatet do të shpallen më së largu deri më 4 tetor 2017 në ueb faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/publikimet>.

6. Lartësia dhe numri i bursave:

Lartësia e bursave është 30 euro në muaj, apo 300 euro për gjithë vitin shkollor.

Numri i bursave do të përcaktohet nga Këshilli Drejtues i projektit si dhe në bazë të mjeteve të cilat janë në dispozicion për vitin shkollor 2017/2018.

Pagesa e bursave bëhet gjatë vitit mësimor, përmes xhironlogarisë, në bazë të kësteve të përcaktuara nga Këshilli i projektit, në 2 apo më shumë këste.

7. Mënyra e aplikimit:

Forma e aplikimit dhe dokumentacioni përcjellës i kërkuar sipas këtij konkursi dorëzohet në MASHT në katin e parë, përdhes, Rruga: Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret për përfitim të bursës, ka afat anekese brenda 3 ditëve, nga koha e shpalljes së rezultateve në uebfaqen e MASHT.

Ankesa do t'i paraqitet Komisionit përzgjedhës për ndarjen e bursave (në MASHT) dhe në raste të jashtëzakonshme edhe komisionit për ankesa dhe parashtrës në MASHT. Ankesa duhet të jetë e arsyetuar dhe të ketë të bashkëlidhura dokumentet që e argumentojnë ankesën. Përgjigjja në ankesë do të jepet brenda 3 ditësh.

Sipas vendimit të Komisionit përzgjedhës për ndarjen e bursave, nxënësi lidh kontratë për bursë me institucionin e caktuar nga Komisioni me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet në lidhje me shfrytëzimin e bursës. Bursa jepet pa obligim për kthim. MASHT-i, do ta bëjë monitorimin e vijueshmërisë së nxënësve përfitues. Shfrytëzuesit të bursës do t'i ndërpritet bursa në rast se është përfitues i ndonjë burse tjetër, nëse braktis shkollimin, apo ka numër të paarsyeshëm të mungesave në vijueshmëri të mësimit dhe ka rënie të madhe të suksesit. Puna me palë në MASHT-Prishtinë bëhet çdo ditë pune prej orës 09:00 -12:00 dhe 13:30-15:30. Pranimi i aplikacioneve bëhet në katin e dytë, Nr. i zyrës 207 në MASHT. Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni në adresat në vijim: fisnikbajrami5@gmail.com apo në nr. tel. 049/100759; 038 200 200 81; dafinasyla@kfos.org dhe a.osmani@vora.org

Zbatuar nga:



**VOICE OF ROMA,
ASHKALI AND EGYPTIANS**